



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5 Maj 2023

Nr: 443

Ora: 12:30

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 347 ID, TË KOALICIONI PËR  
REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ KRYETARIT TË  
BASHKISË KAMËZ, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E  
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 5 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:** Organizata “Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara”

**SUBJEKT:** Z. Rakip Suli, kryetar për bashkinë Kamëz

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ për shkelje administrative

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91 dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 25.3.2023, në adresën email, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar raporti XIV i Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), për gjetjet dhe rekomandimet. Nëpërmjet këtij raporti, është administruar denoncimi për bashkinë Kamëz, i regjistruar me nr. 347 ID, nëpërmjet të cilit pretendohet si më poshtë vijon:

*"Bashkia Kamëz, vijon ende me postimet në faqen zyrtare "Facebook" të bashkisë, të aktivitetit elektoral të kryetarit aktual dhe njëkohësisht kandidatit të Partisë Socialiste në këtë bashki.*

Data: 05 Maj 2023

Nr: 443  
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës për bashkinë Kamëz”

Bashkëngjitur janë dërguar provat link dhe fotot e aktiviteteve të shpërndara si më poshtë vijon:

- *Sot më banorë të frutikulturës, ku morëm falenderime dhe mirënjohje për punën 4 vjeçare, vëmendjen e kushtuar dhe zhvillimin që po merr kjo zonë. #MeRakipSulin #VetëmPërpara#VotoNr1*

Prova link:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0yfALJYhn6y8jUXJmu9UiUTDqQevG4vxG1fpvU4y7UCvLVaKev3m18PXHAjLTmRUtI&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0yfALJYhn6y8jUXJmu9UiUTDqQevG4vxG1fpvU4y7UCvLVaKev3m18PXHAjLTmRUtI&id=100077339029573)

- *#MeRakipSulin #VetëmPërpara#VotoNr1*

Prova link:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0nbDxk2jRjND9HhJCMTLrdb55AxëMyNsghJd4h1tAvUJHËnNdjBN14DKozFqaLifel&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0nbDxk2jRjND9HhJCMTLrdb55AxëMyNsghJd4h1tAvUJHËnNdjBN14DKozFqaLifel&id=100077339029573)

- *Ishim në Lagjen nr. 7 në Bathore për të biseduar nga afër me qytetarët për punët e mira dhe mbështetjen që patën gjatë mandatit tonë të parë. Qytetarë mirënjohës dhe falenderues, që duan të ecin vetëm përpara. #MeRakipSulin #VetëmPërpara#VotoNr1*

Prova link:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMqsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVQëpËVmdGMm5ëPXMëË1ËRs1Ef9LI&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMqsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVQëpËVmdGMm5ëPXMëË1ËRs1Ef9LI&id=100077339029573)

- *Pamje të mrekullueshme nga hapja e fushatës me gratë dhe vajzat ku u ndezëm motorrët drejt 14 Majit, me bindjen e fortë se Kamza këtë herë do të japë mesazhin e duhur për të gjithë Shqipërinë. Kamza e ka bërë zgjedhjen, ka zgjedhur shërbëtorin e saj, ka zgjedhur njeriun e punës, ka zgjedhur derën e hapur për të gjithë dhe këtë do e dëshmojmë masivisht në 14 Maj. #MeRakipSulin #VetëmPërpara#VotoNr1*

Prova link:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMqsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVQëpËVmdGMm5ëPXMëË1ËRs1Ef9LI&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMqsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVQëpËVmdGMm5ëPXMëË1ËRs1Ef9LI&id=100077339029573)

- *Laknas, ku inspektoam nga afër përfundimin e punimeve në rrugën “Kozare” të ndërtuar me standardet më të mira. Asfaltimin, kanalizimet, trotualet sinjalistiken, ndricimin. Investime cilësore në gjithë territorin e Kamzës #BashkiaQëDuam #Përpara14Maj*

Prova Link:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0dUKVpËYuDnFSjVhfu3ZQraqSMs4SeBR6nYCC2CA2më6dzptiëAqYh2FPZzzj9Tëel&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0dUKVpËYuDnFSjVhfu3ZQraqSMs4SeBR6nYCC2CA2më6dzptiëAqYh2FPZzzj9Tëel&id=100077339029573) ;"

Denoncuesi kërkon hetimin e rastit dhe marrjen e masave administrative për personat përgjegjës të kësaj shkelje.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcaktojnë kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të hetimit administrative më datë 26.4.2023, nëpërmjet adresës së postës elektronike i është kërkuar informacion shpjegues personit përgjegjës bashkisë Kamëz, në lidhje me çështjen object denoncimi.

Nga ana e personit përgjegjës për bashkinë Kamëz, nuk kemi administruar asnjë përgjigje.

Më datë 5.5.2023, ora 12:30, u zhvillua seanca dëgjimore, ku u ftuan palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjet objekt shqyrtimi.

Provohet se në faqen zyrtare të rrjetit social “Facebook” të bashkisë Kamëz, janë ripostuar aktivitete të postuara në faqen zyrtare të kryetarit dhe njëkohësisht kandidatit për kryetar bashkie z. Rakip Suli.

Nga verifikimet paraprake dhe provat e administruara vlerësoj që faqja e rrjetit social “Facebook”, me emrin “Bashkia Kamëz”, është faqja zyrtare e institucionit.

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se, referuar nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor “Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti**

*zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.”*

Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në “facebook” apo çdo mjet tjetër elektronik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin dhe ripostimin e veprimtarive me karakter politik/elektoral në zgjedhje, nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi përbën shkelje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe duhet t’i tërhiqet vëmendja të personave përgjegjës në mënyrë që të tregohet kujdes në postimin dhe ripostimin e veprimtarive të ndryshme.

Për rrjedhojë, referuar nenit nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën veprë penale, *dënohet me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.*

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenin 91 dhe 171, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

#### **V E N D O S:**

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për z. Rakip Suli, kryetar për bashkinë bashkinë Kamëz, në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë.
2. Të urdhëroj fshirjen e çdo postimi apo ripostimi me karakter elektoral nga faqja zyrtare e bashkisë Kamëz.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

Kopje: 4

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:

I.Horanlliu \_\_\_\_\_

M.Koja \_\_\_\_\_

A. Lamçe \_\_\_\_\_

Y.Merkaj \_\_\_\_\_

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 05 Maj 2023

Nr: 443  
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës për bashkinë Kamëz”